

Sek. Menaxhimi
Sek. Aradimit
1.6.21

Menaxhimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 891 / prot. 1

Tiranë, më 01.06.2021

URDHËR

Nr. 437, datë 01.06.2021

PËR

**NJË SHITESË NË DOKUMENTIN “POLITIKA DHE PROCEDURA E MENAXHIMIT
TË PERSONELIT CIVIL NË FORCAT E ARMATOSURA, QË NUK GËZOJNË
STATUSIN E NËPUNËSIT CIVIL”, TË MIRATUAR ME URDHËR TË MINISTRIT TË
MBROJTJES NR. 1091, DATË 02.06.2016**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të pikës 2, shkronja “F”, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, datë 26.06.2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

U R D H Ë R O J:


1. Në dokumentin “Politika dhe procedurat e menaxhimit të personeli civil në Forcat e Armatosura, që nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil”, të miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes nr. 1090, datë 02.06.2016, në kreun VII, pas pikës 5, të shtohet pika 6 me përmbajtjen si më poshtë:

6. Transferimi për rastet emergjente, të punonjësve civil të Forcave të Armatosura dhe strukturave të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes.

a) Në rastet emergjente, strukturat e Forcave të Armatosura dhe ato të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes, të cilat kanë pozicione pune të lira, i drejtohen strukturës përkatëse të burimeve njerëzore për plotësimin e tyre.

- b) Në rast se ka kërkesa nga punonjës civil të strukturave të FA-së për transferim, pas vlerësimit nga strukturat përkatëse, këto pozicione plotësohen drejtpërdrejtë pa ndjekur procedurat standarde të parashikuara në këtë dokument.
2. Përgjigjen për zbatimin e këtij urdhri: komandantët e Forcave, komandanti i Komandës Mbështetëse, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, komandantët e njësive dhe reparteve të varësisë së drejtpërdrejtë të MM-së dhe SHPFA-së, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shërbimeve dhe Drejtoria e Personelit (J-1) në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së.
3. Ndjekin zbatimin e këtij urdhri sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


MINISTRI
Niko Peleshi



MINISTRIA E MBROJTJES